

Vendim nr. 171 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (P) 2023 të Regjistrit
Themeltar që i përket:

KËRKUESE: PARTIA BASHKIMI POPULLOR I PENSIONISTËVE

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 21, datë 13.07.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Shfuqizimi i aktit të pushtetit publik nr. 12395, datë 01.12.2022, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 71, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 20, 21, 24, 124, 139, 145, 152, 160, 161, 162, 163 dhe 167 të Kodit Zgjedhor (KZ); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020 Presidenti i Republikës (*Presidenti*) ka caktuar datën 25.04.2021 si datë të zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë (*Kuvendi*).

2. Në datën 25.04.2021 në 12 zonat zgjedhore janë zhvilluar zgjedhjet për Kuvendin. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve (*kërkuesja*) ka marrë pjesë në këto zgjedhje si pjesë e koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës - Konservatorët” (ABEOK), i cili është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 117, datë 08.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ).

3. Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, KSHZ-ja ka miratuar rezultatin e votimit për çdo zonë zgjedhore. Në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve të ankimit, KSHZ-ja ka përlogaritur shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për çdo zonë zgjedhore.

4. Kërkuesja i është drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), duke kërkuar shpalljen të pavlefshme të votimeve të datës 25.04.2021 për zgjedhjet për Kuvendin dhe përsëritjen e tyre, pasi nuk është zbatuar neni 24 i KZ-së, për sa kohë që nuk është marrë vendim për votimin nga jashtë shtetit, çka i bën këto zgjedhje të pavlefshme sipas nenit 160 të KZ-së. Kjo ankesë është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 55 regj., datë 15.06.2021.

5. Në lidhje me këtë ankesë KAS-i, me vendimin nr. 96, datë 17.06.2021, ka vendosur mospranimin e saj. Sipas tij, subjekti ankues nuk referon asnjë vendim të cilin kundërshton dhe objekti i kërkesës nuk përfshihet në asnjë nga pikat e nenit 21 të KZ-së. Për sa i takon votimit nga jashtë, KAS-i ka vlerësuar se kompetenca për të marrë vendim lidhur me rregullat dhe procedurat përkatëse i takon Komisionit Rregullator. Duke qenë se subjekti pretendon se nuk është marrë vendim sipas nenit 24, pika 1, të KZ-së, referuar nenit 145, pika 2, të këtij Kodi, subjektet kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor (KZGJ) për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja, për rrjedhojë KAS-i nuk është organi kompetent. Po sipas këtij vendimi, nëse subjekti ankues kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre, afati është 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe se ka kaluar çdo afat ligjor për paraqitjen e një kërkesë të tillë.

6. Pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve të ankimit, me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, Komisioni Rregullator i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25.04.2021. Ky rezultat përfundimtar përfshin numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt në çdo zonë zgjedhore, si dhe numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt zgjedhor në shkallë vendi.

7. Po kështu, rezulton se edhe koalicioni ABEOK i është drejtuar KQZ-së me kërkesën e datës 06.04.2021 për pajisjen me aktin normativ të procedurave të detajuara të votimit nga jashtë vendit, në kuptim të nenit 24 të KZ-së. Duke qenë se nuk ka marrë përgjigje nga KQZ-ja, ky subjekt ka paraqitur ankim në KZGJ, me objekt detyrimin e KQZ-së që ta pajisë me vendimin sipas nenit 24 të KZ-së, në përputhje me nenin 145, pika 2, të këtij Kodi. Në lidhje me këtë ankim, me vendimin nr. 22, datë 09.09.2021, KZGJ-ja ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes dhe gjobitjen e paditëses në shumën 75,000 lekë për abuzim me të drejtën e ngritjes së padisë. Sipas Kolegjit, ajo ka paraqitur të njëjtën mosmarrëveshje të paraqitur më parë me padinë nr. 27 të regjistrin themeltar, datë 28.07.2021, për të cilën Kolegji, me vendimin nr. 21, datë 09.09.2021, ka vendosur rrëzimin. Pavarësisht referencës ligjore në të dyja paditë, në thelb, mosmarrëveshja ka të njëjtin shkak ligjor, që ka të bëjë me pretendimin e paditëses për detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim dhe për të rregulluar me akt normativ procedurën e votimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë dhe në kuptim të nenit 451 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të gjykohet përsëri.

8. Ky vendim është kundërshtuar nga paditësja në lidhje me pikën 2 të tij, që i përket gjobitjes së saj dhe me vendimin nr. 22/1, datë 16.12.2021, KZGJ-ja ka vendosur të lërë në fuqi gjobën e vendosur, pasi nuk i ka gjetur të bazuara shkaqet e ankimit.

9. Rezulton, gjithashtu, se shtetasi Selami Jenisheri, kryetar i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, Kuvendit, për t'i paguar pagën deri në momentin e mbarimit të mandatit si deputet. Në lidhje me këtë kërkesëpadi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 12395, datë 01.12.2022, i është drejtuar KQZ-së me kërkesë për informacion, duke i kërkuar që, për nevoja të këtij gjykimi, t'i vihet në dispozicion informacioni në lidhje

me shqyrtimin e ankimit nr. 55, datë 14.06.2021 të subjektit ankues Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë.

10. Me shkresën nr. 3809/1 prot., datë 19.12.2022, KQZ-ja i ka kthyer përgjigje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë se kërkesa ankimore është marrë në shqyrtim, duke i dërguar bashkëlidhur kopje të kërkesës ankimore dhe të vendimit nr. 96, datë 17.06.2021 të KAS-it.

11. Në datën 19.05.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuases

12. ***Kërkesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar sa vijon:

A) Për legjitimimin

12.1. Kërkesja legjitimohet në paraqitjen e këtij ankimi, pasi ka qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021.

B) Për themelin

12.2. Kërkesa ankimore e datës 14.06.2021, për zgjedhjet e datës 25.04.2021, nuk është shqyrtuar nga KQZ-ja dhe përbën shkelje të nenit 167 të KZ-së, sipas të cilit nuk mund të nxirren rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, për pasojë nuk mund të shpërndahen mandate. KQZ-ja nuk ka respektuar dispozitat e KZ-së mbi të cilat janë zhvilluar zgjedhjet e datës 25.04.2021, konkretisht nenet 21, 124, 139, 145, 152, 160, 161, 162, 163 dhe 167, për rrjedhojë nuk mund të kemi mandate të ligjshme të deputetëve e as Kuvend të ligjshëm, qeveri të ligjshme dhe dekretim të ligjshëm të zgjedhjeve të datës 14.05.2023 nga Presidenti. Kjo shkel rëndë Kushtetutën dhe sjell pasoja për buxhetin e shtetit, ku deputetët e Kuvendit të legjislaturës IX-të nuk lejohen të ushtrojnë të drejtat e tyre si deputetë të ligjshëm deri në zgjedhjet pasardhëse të ligjshme në përputhje me KZ-në dhe Kushtetutën.

12.3. KQZ-ja nuk ka shqyrtuar kërkesën ankimore nr. 55 të datës 14.06.2021 të kërkuases, por ka dhënë përgjigje për një kërkesë tjetër me të njëjtin numër, por të datës 15.06.2021, për të cilën nuk është kërkuar informacion nga gjykata administrative. KQZ-ja ka vijuar të mos shqyrtojë kërkesat ankimore

të paraqitura pranë saj nga koalicioni ABEOK, ndërkohë që Kuvendi i ri është i paligjshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesses

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

15. Kolegji vëren se, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuessin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Kurse sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Referuar objektit të kërkesës konstatohet se kërkuessa ka ngritur dy kërtime: i) shfuqizimin e vendimit nr. 21, datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin të zhvilluara në datën

25.04.2021; ii) kundërshtimin e shkresës nr. 12395, datë 01.12.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë drejtuar KQZ-së për kërkim informacioni.

17. Në lidhje me kërkimin e parë, Kolegji vëren se sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se koalicioni ABEOK, pjesë e të cilit ka qenë edhe kërkuesja, është regjistruar me vendimin nr. 117, datë 08.03.2021 të KSHZ-së për të marrë pjesë si subjekt zgjedhur në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021. Sipas vendimit të kundërshtuar nr. 21, datë 13.07.2021, ky subjekt ka marrë 0,08725 të votave në rang vendi, për rrjedhojë asnjë mandat për Kuvendin. Sipas pikës 5 të nenit 2 të KZ-së, “koalicion” është grupimi i dy apo më shumë partive politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në të, kurse sipas pikës 20 të po këtij neni, “subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Në kuptim të këtyre dispozitave, për sa kohë që kërkuesja nuk ka qenë subjekt zgjedhor i regjistruar në këto zgjedhje, edhe pse pjesë e një koalicioni zgjedhor, ajo nuk provon interesin e saj të drejtpërdrejtë për të kërkuar mbrojtje kushtetuese në emër të subjektit zgjedhor ndaj të cilit ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta akti i kundërshtuar në objekt të kërkesës.

18. Nga ana tjetër, edhe pse kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e KQZ-së për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, në thelb, ajo e lidh këtë kërkim me shkeljen nga ana e KQZ-së të nenit 24 të KZ-së, pasi nuk është marrë vendim për votimin nga jashtë shtetit, dhe nenit 167 të Kodit, çka, sipas saj, i bën këto zgjedhje të pavlefshme, për rrjedhojë edhe rezultatin e shpallur. Kjo nënkupton se nuk mund të kemi mandate të ligjshme të deputetëve e as Kuvend të ligjshëm, qeveri të ligjshme dhe dekretim të ligjshëm të zgjedhjeve të datës 14.05.2023. Sipas kërkueses, kjo shkel rëndë Kushtetutën dhe sjell pasoja për buxhetin e shtetit, ku deputetët e Kuvendit të legjislaturës IX-të nuk lejohen të ushtrojnë të drejtat e tyre si deputetë të ligjshëm deri në zgjedhjet pasardhëse të ligjshme në përputhje me KZ-në dhe Kushtetutën.

19. Kolegji vlerëson se në lidhje me këto pretendime kërkuesja nuk ka arritur jo vetëm të evidentojë bazën kushtetuese ku mbështetet në paraqitjen e kësaj kërkesë, por as nuk ka arritur të provojë, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, cenimin e ardhur në të drejtat e saj kushtetuese për shkak të veprimtarisë së kundërshtuar të organeve shtetërore. Vetëm fakti se ajo është një parti politike e regjistruar sipas ligjit, nuk i jep asaj të drejtë të investojë Gjykatën në lidhje me procesin zgjedhor, në rast se nuk arrin të provojë se ajo është

prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe procesi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta në veprimtarinë ose të drejtat e saj.

20. Për sa i takon kërimit të dytë të objektit të kërkesës, që ka të bëjë me kundërshtimin e shkresës nr. 12395, datë 01.12.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton ajo gjykatë është vënë në lëvizje nga shtetasi Selami Jenisheri për shqyrtimin e kërkesëpadisë me objekt detyrimin e palës së paditur, Kuvendit, për t'ë paguar pagën deri në momentin e mbarimit të mandatit të tij si deputet. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 12395, datë 01.12.2022, i është drejtuar KQZ-së me kërkesë për informacion, duke i kërkuar që, për nevoja të këtij gjykimi, t'ë vihet në dispozicion informacioni në lidhje me shqyrtimin e ankimit nr. 55, datë 14.06.2021 të subjektit ankues Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë. Me shkresën nr. 3809/1 prot., datë 19.12.2022, KQZ-ja i ka kthyer përgjigje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë se kërkesa ankimore është marrë në shqyrtim dhe i ka dërguar bashkëlidhur kopje të kërkesës ankimore dhe të vendimit nr. 96, datë 17.06.2021 të KAS-it.

21. Për rrjedhojë, edhe pse ky shtetas sipas vërtetimit të datës 20.04.2023 të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kryetar i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve, pra i kërkueses, dhe në këtë cilësi ka nënshkruar edhe kërkesën drejtuar Gjykatës, të drejtat që kërkohen të mbrohen në procesin gjyqësor të iniciuar në gjykatat e zakonshme kanë të bëjnë me statusin e deputetit dhe lidhen me ushtrimin e atij funksioni. Në këto kushte, kërkuessa nuk legjitimohet as për të kërkuar mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të këtij individi.

22. Kolegji vlerëson se, në kushtet që kërkuessa nuk arriti të provojë interesin e saj për t'ju drejtuar kësaj Gjykate, nuk është e nevojshme të vijohet me vlerësimin e kriterëve të tjera për legjitimimin e saj.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.